



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË

Nr. 600 **Prot.**

Tiranë, më 28. 12. **2018**

Lënda: Raport i aktivitetit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë për periudhën Janar- Dhjetor 2018

Drejtuar: Ministrit të Kulturës

Qendra Kombëtare e Kinematografisë - QKK, është institucion qendror, që ushtron aktivitetin në zbatim të ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, "Për kinematografinë" të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të zbatim të tij. Misioni kryesor i QKK është financimi dhe promovimi i prodhimit kinematografik në Shqipëri, nëpërmjet administrimit të fondeve publike, me qëllim zhvillimin e industrisë së filmit në vendin tonë.

Viti 2018, ka qenë për stafin e QKK një vit i mbushur me angazhime dhe impenjime konstante, për realizimin e objektivave, në shërbim të komunitetit të kineastëve dhe në funksion të zhvillimit të kinematografisë shqiptare, promovimit dhe integritetit të saj rajonal dhe më gjerë.

Gjatë vitit 2018 QKK hapi 3 sezone konkurimi. Në vitin 2018 pas procesit të vlerësimit fitojnë të drejtën për financim 36 projekte kinematografike, e më konkretisht:

- 6 projekte filmike me metrazh të gjatë (Bashkëprodhim minoritar).
- 8 projekte filmike me metrazh të shkurtër.
- 5 projekte filmike dokumentarë.

Bul. "Aleksandër Moisiu", Nr.77, Tiranë
Tel/Fax. 378 004

E-mail: info@nationalfilmcenter.gov.al

Website: www.nationalfilmcenter.gov.al

- 4 projekte filmike të animuar.
- 6 Festivale Filmi.
- 7 projekte të ndryshme kinematografike.

Shënim: Është hapur sezoni i konkurimit për projektet për filma me metrazh të gjatë (karriere), filma me metrazh të gjatë - vepër e parë, projekte për zhvillim, si dhe projekte promocioni dhe distribucioni i filmit shqiptar.

Në periudhën Janar - Dhjetor 2018, janë realizuar këto aktivitete dhe financime për projekte kinematografike:

ARRITJET SPECIALE TË VITIT 2018.

1. Për herë të parë një film shqiptar arrin të marrë vlerësimin maksimal në një festival ndërkombëtar filmi të Kategorisë A. Filmi artistik **“Delegacioni”**, skenari Artan Minarolli, regjia Bujar Alimani, u vlerësua me çmimin **“Grand Prix”**, në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Varshavë.

2. Përzgjedhje dhe pjesëmarrje e 2 filmave të metrazhit të gjatë në festivale ndërkombëtare filmi të Kategorisë A:

- **“Delegacioni”**, në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Varshavë;

- **“Streha mes reve”**, në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit Tallinn Black Nights Film Festival.

3. U xhiruan 16 projekte filmike, duke shënuar kështu numër rekord xhirime të filmave brenda një viti:

- *Filma artistikë me metrazh të gjatë:*

1. “Një jetë me ty”, regjia Erion KAME;
2. “LOVE”, regjia Dionis PAPADHIMITRI;
3. “3 luanë në Venecia”, Regjia Jonid JORGJI;
4. “Liqeni im”, Regjia Gjergj XHUVANI;

5. “Bolero në vilën e pleqve”, regjia Spartak PECANI;
6. “Xixëllonjat”, Regjia Artur GORISHTI;
7. “Portreti i pambaruar i Klara Belinit”, Regjia Namik AJAZI;
8. “Emili”, Regjia Ajola DAJA;
9. “I tretuni”, Regjia Arben THAÇI;
10. “Zana”, Regjia Antoneta KASTRATI;

- *Filma artistikë me metrazh të shkurtër*

1. “Rrugës”, Regjia Irdit KASO;
2. “Girls”, Regjia Elgjana GJIPALI;
3. “Vulë”, Regjia Valmir TERTINI;

- *Filma dokumentarë*

1. “La Madonna di Scuttari”, Regjia Fabian KATI;
2. “2 A-të e mëdha”, Regjia Ylli PEPO;

- *Film i animuar*

1. “Man Wanted”, Regjia Irida ZHONGA

Premiera Filmash të realizuara në vitin 2018: Janë përfunduar dhe kanë realizuar premierat për publikun 12 projekte filmike, si më poshtë vijon:

- **Filma artistikë metrazh të gjatë:**

1. “Ndërkombëtarët”, skenari Ylljet Aliçka, regjia Pluton Vasi;
2. “Delegacioni”, skenari Artan Minarolli, regjia Bujar Alimani;
3. “Streha mes reve”, skenari dhe regjia Robert Budina;
4. “Procedurat”, skenari Suela Bako Ergys Meta, regjia Suela Bako, Ergys Meta;

5. “Martesa”, skenari Blerta Zeqiri, Kreshnik Berisha, regjia Blerta Zeqiri;
6. “Nëntori i ftohtë”, skenari dhe regjia Ismet Sijarina;
7. “Loja e parave”, skenari dhe regjia Antonio Morabito;
8. “Holy Boom”, skenari dhe regjia Maria Lafi.

• **Filma artistikë me metrazh të shkurtër:**

1. “Atila”, skenari dhe regjia Benart Laze;
2. “Ne kemi diellin”, skenari dhe regjia Petrit Ruka;
3. “Poeti”, skenari Ylljet Aliçka, regjia Atina Laço;
4. “Girls”, skenari dhe regjia Elkjana Gjipali.

FESTIVALE NDËRKOMBËTARE FILMI TË ORGANIZUARA BRENDA VENDIT:

1. Festivali Ndërkombëtar i Filmit “A-Film Fest Argjiro- Rozafa”, Shkodër, Prill 2018;
2. Festivali Ndërkombëtar i Filmit dhe Kulinarisë, Pogradec, Korrik 2018;
3. Festivali Ndërkombëtar i Filmit “K:OSH”, Korçë, Korrik 2018;
4. Festivali Ndërkombëtar i Filmit “DEA Film Fest”, Sarandë, Shtator 2018;
5. Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut “IRHFFA”, Tiranë, Shtator 2018;
6. Festivali Ndërkombëtar i Filmit “TIFF”, Tiranë, Nëntor 2018.

PROJEKTE TË NDRYSHME KINEMATOGRAFIKE:

1. Projekti kinematografik “Java e filmit spanjoll” në kinema “K. Roshi, Kuçovë, Mars 2018;
2. Projekti “Open Cinema në Lungomare- Vlorë” Gusht 2018;
3. Projekti “Pjesëmarrja në “TalentCampus, - Odense Film Workshop Danimarkë”, Shtator 2018;

4. Edicioni i dytë i Balkan Film Market, event i cili u zhvillua në 3-7 Tetor, nën patronazhin e Eurimages, ku morën pjesë mbi 240 përfaqësues nga 28 institucione dhe industria e filmit nga 25 vende të ndryshme. Informacione të detajuara për këtë aktivitet i prezantojmë bashkëlidhur;
5. Projekti “Java e filmit Evropian” në kinema “K. Roshi, Kuçovë, Nëntor 2018;
6. Projekti “Premierë evropiane e trilogjisë së filmave të restaurar dhe digitalizuar të regjisorës Xhanfize Keko” në Danish Film Institute, Kopenhagen, Nëntor 2018;
7. Projekti “48 Hour Film Project”, Tiranë, Dhjetor 2018.

PJESËMARRJE NË AKTIVITETE DHE FESTIVALE NDËRKOMBËTARE FILMI JASHTË VENDIT:

1. Pjesëmarrja e filmit shqiptar në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Trieste, Janar 2018;
2. Stenda e kinematografisë shqiptare në Festivalin e Filmit në Berlin, Shkurt 2018;
3. Stenda e kinematografisë shqiptare në Festivalin e Filmit në Kanë, Maj 2018;
4. Prezantimi i filmit të animuar shqiptar në edicionin e 11të të AnimaSyros Fest + Athens Animation Agora, Shtator 2018;
5. Festivali i Filmit në Warshavë, Poloni, Tetor 2018;
6. Festivali i Filmit në Tallin, Estoni, Nëntor 2018.
7. Pjesëmarrje në “Edicionin e 15të të Sofia Meetings”, zhvilluar gjatë Festivalit Ndërkombëtar të 22të të Filmit në Sofie, Bullgari.
8. Pjesëmarrje në “Festivalin e Venecias”.
9. Pjesëmarrje në “MIA- Italian Market of Audiovisual”, Romë, Itali.
10. Pjesëmarrja e Kryetarit të QKK, z. Ilir Butka dhe Drejtorit të Media Desk Albania, z. Arben Papadhopulli, në mbledhjen për koordinimin e punës së projektit CIRCE – “Common Initiatives to pRomote CinEma across Italy-Albania-Montenegro” në Bari, Itali.

11. Pjesëmarrje në edicionin e 9të të Apulia Film Forum, Monopoli, Itali.
12. Pjesëmarrje në Torino Short Film Market me një seksion të dedikuar për filmin e shkurtër Ballkanik ku nga Balkan Film Market e cila është një iniciativë e QKK, u prezantuan 5 filma të realizuara nga regjisore femra.

FONDE ALTERNATIVE TË SIGURUARA GJATË VITIT 2018

1. Nëpërmjet programit Interreg IPA Cross-border Cooperation Programme "Italy-Albania-Montenegro", u nënshkrua kontrata për realizimin e projektit "Common Initiatives to promote CinEma across Italy-Albania-Montenegro". Ky projekt me vlerë 180.000 Euro krijon premisën për bashkëpunim midis 3 vendeve dhe ndër të tjera konsiston në hapjen e kinemave në rrethe dhe sigurimin e mjeteve teknike (pajisjen me projektorë digitalë) për funksionimin e tyre. Fillimisht ky projekt pilot do të fillojë të aplikohet në qytetin e Gjirokastrës dhe Vlorës ku edhe janë nënshkruar kontratat me Bashkitë përkatëse për menaxhimin e kinemave nga QKK për një periudhë 10-vjeçare.
2. Është financuar nga Eurimages 1 projekt filmik i metrazhit të gjatë.
3. Është financuar nga SEE Cinema Network 1 projekt filmik me metrazh të gjatë.
4. Ndërkohë gati të gjitha projektet e filmave me metrazh të gjatë janë realizuar duke siguruar fonde nga bashkëprodhuesit e huaj.

INICIATIVA LIGJORE, TË NDËRMARRA NË BASHKËPUNIM ME INSTITUCIONET QENDRORE DHE VENDORE:

1. Propozimi dhe përgatitja e projektvendimit "Për rimbursim të pjesshëm të fondeve të investuara të projekteve kinematografike dhe audiovizuale të huaja që kryejnë xhirimet në territorin e Republikës së Shqipërisë". Në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë po punojmë për implementimin e një skeme të re financimi për realizimin e mbështetjes për produksionet e huaja që duan të realizojnë xhirimet në territorin shqiptar.

2. Nënshkrimi i Aktmarrëveshjes me AFMM “Marubi”, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit.

3. Po punohet për krijimin e Albania Film Commission në bashkëpunim me organet e pushtetit qendror dhe vendor për konceptimin e statusit legal strukturimin dhe funksionimin e kesaj hallke të rëndësishme që lidh mbarëvajtjen e sektorit audiovisual me promovimin e territorit.

Buxheti i QKK për vitin 2018:

Totali i buxhetit të QKK për vitin 2018, ka qenë 164.3 milion Lekë nga këto:

- 131.8 milionë Lekë për mbështetje ekonomike për projekte kinematografike,
- 2 milionë Lekë për investime.
- Të ardhurat janë realizuar në masën 4 milionë Lekë, të cilat janë derdhur 100% në buxhetin e shtetit.

Ju falënderoj për vëmendjen.

Ilir BUTKA

KRYETAR

